




Eventet Koktej u bënë shumë popullore në vitet '90, ndërkoë që në vendin tonë ato filluan të aplikohen pas viteve 2000. Zgjedhjet e tilla janë shumë të përshtatshme për të celebruar raste të ndryshme kulturore, akademike, biznesi apo miqësore. Koktej Party zgjasin rreth 2-3 orë dhe në to shërbehen aperitivë dhe pije të ndryshme.

Nëse organizon një koktej party për herë të parë atëherë ky artikull do të të ndihmojë për një planifikim sa më të mirë. Ndiq hapat dhe këshillat tona...

Planifikimi paraprak: një muaj para aktivitetit



Një koktej party organizohet shumë më lehtë nëse përpilon një axhendë paraprake, në mënyrë që ti realizosh të gjitha gjërat në mënyrën e duhur dhe në kohë.

1. **Cakto datën.** Ditët më të përshtatshme për një koktej party janë ditët e fundit të javës, si e premjta dhe e shtuna pasi të ftuarit pothuajse i kanë mbyllyr angazhimet intensive të punës dhe të nesërmen e eventit mund të pushojnë.
2. **Zgjidh vendin.** Nëse planifikon diçka mes miqsh, mund të zgjedhësh shtëpinë apo të prenotosh një ambient në një kafe apo bar të këndshëm. Nëse bëhet fjalë për një event pune, atëherë vendi i përshtatshëm do të ishte një sallë e prenotuar në një hotel ose restorant.
3. **Vendos listën e të ftuarve.** Hapi tjetër i rëndësishëm është lista e të ftuarve. Për këtë sigurisht që do të bazohesh në rastin e eventit. Bëj kujdes që mos të harrosh asnjë person të rëndësishëm, prandaj jepi vetes kohë për listën dhe rishihe disa herë para se të nisësh ftesat apo të njoftosh personat për eventin.
4. **Porosit dhe dërgo ftesat.** Pasi ke caktuar vendin dhe orën e saktë të eventit dhe ke përfunduar listën e të ftuarve, është koha të porosisësh ftesat e ti nisësh ato tek personat përkatës.
5. **Planifiko buxhetin.** Megjithëse mund të mendosh se ska shumë rëndësi buxheti pasi një party koktej ska shumë shpenzime, gjithsesi është mirë të planifikosh një buxhet e t'i përmbahesh atij.

Planifikimi i detajeve: 2 - 3 javë para aktivitetit

Tani është momenti të mendosh për detajet dhe të bësh përgatitjet e duhura:



- **Ushqimi**- nuk është e nevojshme ta teprosh me ushqimin pasi koktej party ka për qëllim mbledhjen e njerëzve bashkë për një rast të caktuar. Ajo që duhet janë aperitivë të ndryshëm, duke përfshirë snacks, lloje të ndryshme djathrash dhe proshutash, gatime mishi në miniaturë, perime etj. Mos harro edhe ëmbëlsirat, frutat dhe sigursht pijet: si alkolike ashtu edhe joalkolike. Kujdesu edhe për menyrën e servirjes së tyre.
- **Dekorimi**- aktivitetet koktej organizohen me një rast të caktuar dhe sigurisht që kanë në vetvete një pjesë formale dhe festive, prandaj edhe dekorimi i ambientit ku zhvillohet party duhet bërë me kujdes të veçantë në mënyrë që ti përshtatet rastit.
- **Argëtimi** - ai nuk është qëllimi kryesor i një party koktej, por atmosfera duhet të jetë e ngrohtë dhe relaksuese. Kujdesu që në party mos të mungojë muzika dhe që ajo të jetë në përputhje me rastin dhe pritshmëritë e të ftuarve.
- **Urimet** - për të lënë një përshtypje sa më të mirë tek të ftuarit, mos i li ata të largohen nga party pa i falenderuar. Mund të mbash një fjalim përhëndetës dhe të falenderosh të ftuarit për pjesëmarrjen e tyre. Gjithashtu mund të parapregatisësh edhe surpriza të

tilla të këndshme për të ftuarit: si: biskota me shprehje të fatit, paketa më çokollata që u jepen të ftuarve para se të largohen nga party, apo çdo gjë tjetër që do ta mbajë më të gjatë dhe të këndshme shijen e aktivitetit tek të ftuarit.

Etiketa në një party koktej



Ruajtja e etiketës është gjithmonë shumë e rëndësishme. Më poshtë janë përmendur rregullat më të rëndësishme të etiketës që duhet të kesh parasysh për organizimin e një party koktej.

Sa pije duhet të kem rezervë?

Ti duhet të parashikosh rreth 3-4 pije për çdo të ftuar. Gjithsesi mundohu që të kesh rezervë edhe disa shishe të tjera me pije për çdo rast.

Kur fillon zakonisht një koktej party?

Koha më e përshtatshme është rreth orës 6-8 të pasdites.

Çfarë duhet të bëj që të jem një mikpritës i mirë?

Si organizator dhe mikpritës në party, është shumë e rëndësishme që ti presësh të ftuarit, ti prezantosh ata me njëri-tjetrin e të levizësh midis të ftuarve duke alternuar qëndrimin dhe komunikimin tënd midis grupeve të ndryshme, në mënyrë që të ftuarit të mos ndihen të harruar apo mënjeluar. Kujdesu që gjatë party gjërat të ecin mirë e ku mund të ketë probleme, mundohu që tu japësh drejtimin e duhur sa më shpejt.